

VENDIM
Nr.146, datë 28.3.2007

**PËR SHKRIRJEN E INSTITUTIT TË INFORMATIKËS DHE MATEMATIKËS SË
APLIKUAR DHE RIORGANIZIMIN E TIJ, SI PJESË PËRBËRËSE E UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.440, DATË
16.6.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AKADEMISË SË SHKENCAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik” të ndryshuar, të neneve 10, 13 e 15 shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkrirjen e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar (INIMA) dhe riorganizimin e tij, si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës.
 2. Numri i punonjësve, fondet buxhetore, të miratuara për vitin 2007, vlerat materiale, mjetet e inventarit dhe bilanci kontabël i INIMA-s i transferohen Universitetit Politeknik të Tiranës.
 3. Mjediset (truall, ndërtesë), në përdorim të INIMA-s dhe në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave, i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave.
 4. Objekti me numër rendor 1, në formularin, që i bashkëlidhet vendimit nr.440, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave”, të hiqet nga kjo listë.
 5. Ngarkohet INIMA të mbyllë të gjitha procedurat me të tretët, në rastet e kontratave të qiradhënies së mjediseve të saj.
 6. Ngarkohet INIMA, që të marrë të gjitha masat për lirimin e menjëhershëm të njërës prej kateve të ndërtesës dhe, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit, për lirimin e kateve të tjera të saj.
 7. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha